

**VENDIM**  
**Nr.1067, datë 29.12.2010**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË**  
**PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA SISTEMIM - ASFALTIMI I**  
**BLLOKUT LINDOR, LAGJJA E STANIT NË BASHKINË E DIVJAKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemim - asfaltimi i bllokut lindor, Lagjja e Stanit, në bashkinë e Divjakës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Divjakës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 323 (treqind e njëzet e tre) m<sup>2</sup>, tokë truall, pronë private, në masën e përgjithshme të shpronësimit, 807 500 (tetëqind e shtatë mijë e pesëqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Divjakës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet po nga bashkia e Divjakës.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Divjakës, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë, 323 (treqind e njëzet e tre) m<sup>2</sup>, tokë truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Divjakës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënim “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë bashkisë së Divjakës. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Divjakës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN**  
**PËR “SISTEMIM-ASFALTIMIN E BLLOKUT LINDOR, LAGJA E STANIT”, NË BASHKINË E**  
**DIVJAKËS**

| Nr. | Emër, mbiemër | Sip. truall<br>m <sup>2</sup> | Çmimi<br>lekë/m <sup>2</sup> | Vlera në<br>lekë | Nr. i<br>pasurisë | Zona<br>kadastrale | Dokumentet e<br>pronësisë |
|-----|---------------|-------------------------------|------------------------------|------------------|-------------------|--------------------|---------------------------|
| 1   | Panajot Tashi | 90                            | 2500                         | 225 000          | 452/21            | 1492               | Proces                    |
| 2   | Thoma Biti    | 233                           | 2500                         | 582 500          | 437/59            | 1492               | Proces                    |
|     |               |                               |                              |                  |                   |                    |                           |
|     | <b>Totali</b> | <b>323</b>                    |                              | <b>807 500</b>   |                   |                    |                           |